

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa, kryetare e kolegjit, Nebojša Boričić dhe Enver Peci, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarve B.L., G.H., M.H. dhe E.L., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje shtytje për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga nenin 141 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPK, dhe F.M., për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale shtytje për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga nenin 141 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të akuzuarve B.L., G.H. dhe E.L., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.162/2017 të datës 19.7.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PN.1.nr.1335/2017 të datës 25.7.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 22.8.2017, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të akuzuarve B.L., G.H. dhe E.L., të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.162/2017 të datës 19.7.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PN.1.nr.1335/2017 të datës 25.7.2017.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.162/2017 e datës 19.7.2017, të akuzuarit B.L., M.H., G.H., E.L., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje shtytja për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK dhe F.M., për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale shtytja për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KPRK, i ka shpallur fajtorë dhe i ka gjykuar: të akuzuarin B.L., për veprën penale në bashkëkryerje shtytja për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 par.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite 6 (gjashtë) muaj, të akuzuarin G.H., për shkak të veprës penale në

bashkëkryerje shtytja për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 par.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 6 (gjashtë) muaj, të akuzuarin M.H., për veprën penale në bashkëkryerje shtytja për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 par.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 6 (gjashtë) muaj, të akuzuarin E.L., për veprën penale në bashkëkryerje shtytja për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 par.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 6 (gjashtë) muaj dhe të akuzuarin F.M., për veprën penale në bashkëkryerje ndihma në kryerjen e veprës penale shtytja për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 par.1 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KPRK, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite. Koha e kaluar në paraburgim për të gjithë të akuzuarit nga data 11.7.2015 e tutje do t'u llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.162/2017 të datës 19.7.2017, të akuzuarve B.L., E.L., M.H., G.H. dhe F.M., për shkak të veprave penale të cekura më lartë, ju vazhdohet masa e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Me aktvendimin Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PN.1.nr.1335/2017 e datës 25.7.2017, janë refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve B.L., E.L., M.H., G.H. dhe F.M., të paraqitura kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtrua:

- mbrojtësja e të akuzuarit E.L., av. S.J., për shkak të shkeljes qenësore të dispozitave të KPPK dhe vendimit mbi vazhdimin e paraburgimit me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën si të bazuar dhe aktvendimet e kundërshtuara ti ndryshojë ashtu që të akuzuarin E.L., t'ia ndërprejë paraburgimin menjëherë.

- mbrojtësi i të akuzuarit G.H., av. A.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitës 384 par.1 nënpar.1.12 dhe par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 lidhur me nenin 367 par.1 lidhur me par.3 e lidhur me dispozitën e nenit 185 par. 2 dhe nenin 5 par.1,2,3,4 të KPPK me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'i anulojë aktvendimet e kundërshtuara dhe të akuzuarit G.H., t'ia ndërprejë paraburgimin menjëherë.

- mbrojtësja e të akuzuarit B.L., av. A.K., për shkak të shkeljes qenësore të dispozitave të KPPK dhe vendimit mbi vazhdimin e paraburgimit me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën si të bazuar dhe që mbi këtë bazë t'a ndryshojë vendimin e formës së prerë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.48/2017 e datës 21.8.2017, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje juridiko – penale në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë gjeti se:

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk janë të bazuara.

Në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të akuzuarve, dy prej të cilave janë gati krejt identike, kërkesa e mbrojtëses e të akuzuarit B.L. të av. A.K. dhe ajo e mbrojtëses e të akuzuarit E.L. të av. S.J., në të cilat kryesisht theksohet se aktvendimet e atakuara janë të pakuptueshme, se nuk kanë arsytim në lidhje me faktet vendimtare dhe se edhe ato të paraqiturat janë plotësisht të paqarta dhe kundërtënëse me vetvete, se sipas dispozitës së nenit 367 par.3 të KPPK nëse dënimi i shqiptuar është më i ultë se 5 (pesë) vjet atëherë paraburgimi caktohet ose vazhdohet nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 187 par.1 të KPPK, ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit G.H., av. A.H., në kërkesën e tij, përveç pretendimeve të lartcekura, kryesisht thekson se paraburgimi nuk është dënim, e as mjet represiv por vetëm masë e sigurisë në procedurë dhe duhet të zgjasë sa më shkurt nga se çështje e paraburgimit të zgjatur është përfshirë edhe në Raportet e vazhdueshme të OSBE, Raportin e Progresit dhe në Konventën Evropiane për Lirit dhe të Drejtat e Njeriu, dhe se nuk ekziston rreziku i ikjes nga i akuzuari nga se të njëjtit dihet identiteti, është njeri familjarë, i martuar dhe prind, dhe i ka premtuar gjykatës se gjithmonë do të paraqitet në çdo thirrje.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, sepse nga shkresat e lëndës rezultojnë dyshimi i bazuar se të akuzuarit janë kryerës të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar me dënim burgimi, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 të KPPK, për vazhdimin e paraburgimit.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.1 të KPP, ngase me lëshimin e të akuzuarve në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, duke pasur parasysh dënimet e shqiptuara si dhe faktin se vendimi ende nuk ka marrë formën e prerë, ashtu që për t'iu shmangur përgjegjësisë penale mund të largohen nga Kosova e kjo dëshmohet nga fakti se G.H. së bashku me F.M., në ditën kritike janë larguar nga vendi i ngjarjes, janë arratisur deri sa janë arrestuar nga policia e Kosovës, si dhe fakti që G.H. dhe B.L., dyshohen se kanë qenë pjesëmarrës në konfliktin e luftës në Siri në radhët e organizatës Terroriste ISIS, fakte këto që japin arsye për të besuar se me gjetjen e tyre në liri do të mund të ikin nga Kosova apo dhe t'i bashkohen përsëri kësaj organizate, e në këtë mënyrë të njëjtit mund të jenë të paarritshëm për organet e drejtësisë dhe kështu do ta pamundësojnë zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Gjithashtu, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, ekzistojnë edhe arsytet ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.3 të KPP, duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës penale, se të akuzuarit kanë vepruar në grup të organizuar mirë dhe sipas marrëveshjes paraprake, se të akuzuarve G.H. dhe B.L. edhe më parë u është caktuar

masa e paraburgimit për vepra penale të kësaj natyre, lë të besohet se me lënien e të akuzuarve në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës penale.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPK janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.211/2017, më datë 22.8.2017

B. profesionale,  
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,  
Emine Mustafa